



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“BLERJE PAJISJE DHE MOBILIMI PËR KOPSHTË DHE ÇERDHE”*

KODI/KODET PËRKATËSE NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39161000-8 – Mobilje për kopësht fëmijësh; 39713200-5 – Lavatriçe dhe tharëse rrobash; 37535200-9 – Pajisje për parqe lojërash.

VLERA E FONDIT LIMIT: 8 328 000 (tetë milionë e treqind e njëzet e tetë mijë) lekë pa TVSH.

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja “c”, si dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. **Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit**, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit;

b. **Sigurimin e Ofertës**, sipas Shtojcës 4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të neneve 26 dhe 30 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit kërkohet si provë paraprake për deklarimin nga operatori ekonomik të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit,

sipas parashikimeve të nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar.

Nëpërmjet këtij formulari, operatori ekonomik deklaron paraprakisht informacionin e kërkuar në lidhje me përmbushjen e kushteve të pjesëmarrjes, mungesën e shkaqeve të detyrueshme për skualifikim, si dhe përmbushjen e kërkesave të tjera që, sipas legjislacionit në fuqi dhe Dokumenteve të Tenderit, provohen paraprakisht nëpërmjet vetëdeklarimit.

Në përputhje me nenin 26 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Autoriteti Kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar të parin paraqitjen e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sigurimi i Ofertës kërkohet në mbështetje të nenit 83 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, dhe nenit 30 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, me qëllim garantimin e përmbushjes nga ofertuesi të detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Vlera e Sigurimit të Ofertës përcaktohet në masën 2% të vlerës së fondit limit të kontratës, në përputhje me nenin 30, pika 3, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, dhe Dokumentet Standarde të Tenderit. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, kërkesat për kualifikim duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar se operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kontratës dhe, në çdo rast, duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e saj.

Duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, e cila ka për objekt furnizimin me pajisje dhe mobilie për kopshte dhe çerdhe, përfshirë mobilie dhe orendi për fëmijë, pajisje për ambiente administrative, lavatriçe profesionale dhe pajisje lojërash për ambiente të jashtme, Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar kërkesa shtesë për licenca profesionale në këtë nënkategori të kriterëve të kualifikimit.

Nga natyra e mallrave dhe e veprimtarive që përbëjnë objektin e kontratës nuk është evidencuar një licencë profesionale e posaçme, e cila, sipas legjislacionit sektorial në fuqi, të jetë e detyrueshme në mënyrë të përgjithshme për të gjithë operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtari prodhimi dhe/ose tregtimi/furnizimi të mallrave objekt prokurimi.

Për këtë arsye, vendosja e një kërkesë shtesë për licencë profesionale, pa ekzistuar një detyrim specifik ligjor që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, nuk vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të saj.

Mosvendosja e kërkesave shtesë në këtë nënkategori është bërë në respektim të parimeve të proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe nxitjes së konkurrencës, duke shmangur vendosjen e kushteve që nuk janë të domosdoshme për realizimin e objektit të prokurimit.

Kërkesat që lidhen me përvojën e ngjashme, dokumentacionin teknik të produkteve, standardet dhe provat e konformitetit, mostrat, garancinë dhe kërkesat e tjera të nevojshme për verifikimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë përcaktohen dhe argumentohen në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” të këtij procesverballi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar, gjatë periudhës së 3 (tre) viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025, një xhiro vjetore në vlerë jo më të ulët se 3 331 200 (tre milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e dyqind) lekë, e cila përfaqëson 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës (fondit limit).

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros së kërkuar në të paktën 1 (një) vit të periudhës së mësipërme.

Për operatorët ekonomikë që e kanë filluar veprimtarinë gjatë periudhës së mësipërme, kriteri vlerësohet në raport me periudhën gjatë së cilës operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet, me kusht që vlera minimale e kërkuar e xhiros të jetë arritur në të paktën një vit financiar të deklarueshëm.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pikat 1, 2, shkronja “c”, 3 dhe 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Referuar nenit 43, pika 1, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojnë deklaratat e xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Për këtë procedurë, vitet e fundit financiare të përfunduara janë 2023, 2024 dhe 2025.

Referuar nenit 43, pika 2, shkronja “c”, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, vlera e xhiros minimale vjetore që mund t'u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Duke qenë se vlera e përllogaritur e kontratës/fondi limit i kësaj procedure është 8 328 000 lekë pa TVSH, vlera minimale e xhiros është përcaktuar në 3 331 200 lekë, e barabartë me 40% të fondit limit.

Përcaktimi i kësaj vlere është bërë duke marrë në konsideratë natyrën, vlerën dhe volumin e kontratës, e cila përfshin furnizimin e një sasive të konsiderueshme mobilie dhe pajisjesh për
Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

kopshte dhe çerdhe, përfshirë mobilie për përdorim nga fëmijët, pajisje për ambiente administrative, lavatriçe profesionale dhe pajisje lojërash për ambiente të jashtme, si dhe detyrimet që lidhen me transportin, dorëzimin, montimin/instalimin sipas rastit dhe garantimin e produkteve.

Kërkesa synon të krijojë siguri të arsyeshme se operatori ekonomik disponon kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për të përballuar realizimin e kontratës, pa krijuar kërkesë që tejkalon kufirin maksimal të përcaktuar nga legjislacioni për procedurat nën kufirin e ulët monetar.

Në përputhje me nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Kërkesa është në përpjesëtim dhe e lidhur me objektin e kontratës dhe synon të sigurojë aftësinë financiare të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të saj, në përputhje me nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të maturuara për vitin 2026, të lëshuar nga njësi/njësitë e vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet, sipas adresave/vendeve të ushtrimit të aktivitetit të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen nga operatori ekonomik të detyrimeve të maturuara për taksat dhe tarifatat vendore në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në QKB, duke respektuar afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar me sukses furnizime të ngjashme, në një vlerë totale jo më të vogël se 1,665,600 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë, që përfaqëson 20% të vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Do të konsiderohen furnizime të ngjashme furnizimet me mobilie/orendi dhe/ose pajisje të ngjashme me një ose më shumë nga kategoritë e mallrave objekt prokurimi.

Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Për përvojën e realizuar me një autoritet/ent publik: vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b. Për përvojën e realizuar me sektorin privat: pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 4, dhe nenit 55, pika 4, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për realizimin e furnizimeve të ngjashme në vlerën 1,665,600 lekë, e cila përfaqëson 20% të fondit limit, është përcaktuar në përputhje me kufirin e parashikuar për procedurën e hapur të thjeshtuar dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit.

Ky kriter synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon përvojën teknike dhe organizative të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës dhe ka realizuar më parë furnizime me natyrë të krahasueshme me mallrat objekt prokurimi.

Përcaktimi i periudhës prej 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, mundëson që përvoja e paraqitur të jetë aktuale dhe e verifikueshme.

Përcaktimi i furnizimeve të ngjashme në lidhje me një ose më shumë kategori të mallrave objekt prokurimi është bërë me qëllim që kriteri të lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pa kërkuar që operatori ekonomik të ketë realizuar më parë një kontratë identike me të gjithë zërat e kësaj procedure, duke shmangur kufizimin e panevojshëm të konkurrencës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion teknik për identifikimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktor, si më poshtë:

- për **lavatriçen profesionale për çerdhe/kopsht dhe karrigen për ambiente administrative**: katalog teknik dhe/ose skedë teknike (datasheet) të prodhuesit;
- për **kompleksin e lojërave dhe lisharësen**: katalog teknik, skedë teknike ose vizatim/skicë teknike të produktit të ofertuar. Në rastin e produkteve që prodhohen ose konfigurohen sipas porosisë, dokumentacioni teknik duhet të identifikojë qartë përmasat, konfigurimin, materialet kryesore dhe karakteristikat teknike të produktit që do të furnizohet.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë identifikimin e qartë të produktit të ofertuar dhe, kur është e aplikueshme, të përmbajë emrin e prodhuesit, modelin, kodin/referencën e produktit ose të dhëna të tjera identifikuese.

Operatori ekonomik duhet të evidentojë në dokumentacionin teknik të paraqitur karakteristikat që provojnë përputhshmërinë me kërkesat minimale të specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

Në rast se dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, pjesët që përmbajnë informacionin e nevojshëm për verifikimin e kërkesave teknike duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 6, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Referuar nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë fotografi apo katalogë teknikë si dëshmi për përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Paraqitja e dokumentacionit teknik është kërkuar vetëm për ato mallra për të cilat karakteristikat funksionale, teknike dhe të sigurisë mund të verifikohen objektivisht nëpërmjet dokumentacionit teknik të produktit.

Për lavatriçen profesionale, dokumentacioni teknik është i nevojshëm për verifikimin e kapacitetit, shpejtësisë së shtrydhjes, programeve, furnizimit elektrik dhe karakteristikave të tjera funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për karrigen administrative, dokumentacioni teknik mundëson verifikimin e tipologjisë, rregullimeve, përmasave, kapacitetit të ngarkesës dhe karakteristikave ergonomike të produktit.

Për kompleksin e lojërave dhe lisharësen, dokumentacioni teknik është i nevojshëm për verifikimin e konfigurimit, përmasave, materialeve dhe elementeve funksionale e të sigurisë të pajisjeve të ofertuara.

Kërkesa nuk është shtrirë për mobilet prej druri dhe orenditë që mund të prodhohen sipas porosisë dhe përmasave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, për të cilat katalogu standard i prodhuesit mund të mos jetë i disponueshëm ose i zbatueshëm.

Përcaktimi i dokumentacionit teknik vetëm për mallrat e mësipërme është bërë në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe me qëllim mundësimin e një vlerësimi objektiv e të verifikueshëm të ofertës teknike, pa vendosur kërkesa të panevojshme që mund të kufizojnë konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion që provon përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë dhe konformitetit, si më poshtë:

a. Për kompleksin e lojërave dhe lisharësen:

Raport testimi **ose** certifikatë konformiteti që provon përputhshmërinë e produktit të ofertuar me standardin **EN 1176, sipas pjesëve të aplikueshme, ose standard ekuivalent**. Dokumenti duhet të jetë lëshuar nga një institucion/organ kompetent për fushën përkatëse; në rastin e certifikatës së konformitetit, organi lëshues duhet të jetë i akredituar sipas legjislacionit në fuqi.

b. Për lavatriçen profesionale:

Produkti i ofertuar duhet të mbajë **markimin CE**, kur ky markim është i zbatueshëm, dhe operatori ekonomik duhet të paraqesë **Deklaratën e Konformitetit të prodhuesit ose dokumentacion ekuivalent të konformitetit**, që provon përputhshmërinë me kërkesat dhe standardet e zbatueshme të përcaktuara në specifikimet teknike.

Dokumentacioni duhet të identifikojë qartë produktin/modelin e ofertuar dhe të jetë në përputhje me dokumentacionin teknik të paraqitur sipas pikës 2.3.2. Pranohen dokumente ekuivalente/barasvlershme që provojnë të njëjtin nivel sigurie dhe performance. Në rast se

Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

dokumentacioni është në gjuhë të huaj, pjesët përkatëse duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “c”, dhe nenit 44 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar.

Kërkesa për dokumentacion konformiteti është vendosur për të verifikuar objektivisht sigurinë dhe përputhshmërinë teknike të produkteve. Për kompleksin e lojërave dhe lisharësën, kërkesa për **EN 1176 ose standard ekuivalent** lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e pajisjeve nga fëmijët dhe nevojën për garantimin e sigurisë gjatë përdorimit. Për lavatriçen profesionale, markimi CE dhe dokumentacioni i konformitetit synojnë verifikimin e kërkesave të zbatueshme të sigurisë së pajisjes.

Kriteri është kufizuar vetëm në produktet për të cilat ky verifikim është i nevojshëm dhe pranon prova ekuivalente, në respektim të parimeve të proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra fizike/materiale për verifikimin e përputhshmërisë së ofertës teknike me specifikimet teknike, si më poshtë:

- **Artikulli nr. 1 – Tavolinë rrethore druri Ø120 cm për fëmijë:** 1 (një) mostër të plotë dhe funksionale;
- **Artikulli nr. 2 – Karrige druri për fëmijë:** 1 (një) mostër të plotë dhe funksionale;
- **Artikulli nr. 3 – Sete të plota shtrati:** mostër materialit druri me përfundimin e propozuar, mostër dysheku/këllëfi dhe skicë/vizatim teknik për secilën tipologji;
- **Artikulli nr. 4 – Dollap druri:** mostra të materialit/përfundimit dhe të aksesoreve kryesorë;
- **Artikulli nr. 5 – Komplet stol dhe varëse rrobash:** mostra të materialit/përfundimit dhe të aksesoreve kryesorë;
- **Artikulli nr. 8 – Tavolinë drejtorie:** mostër të materialit të syprinës/panelit/rimesos me përfundimin e propozuar.

Mostrat do të dorëzohen fizikisht pranë Magazinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, pranë Shkollës “Arben Broci”, Shkodër, brenda afatit të fundit të përcaktuar për paraqitjen e ofertave. Mostrat duhet të jenë të identifikuara qartë me emërtimin e operatorit ekonomik dhe numrin/emërtimin e artikullit. Për marrjen në dorëzim të mostrave do të mbahet dokumentacioni përkatës, ndërsa administrimi dhe kthimi i tyre do të kryhen në përputhje me Udhëzimin e APP nr. 03, datë 12.04.2022.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë Udhëzimin e APP nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”. Udhëzimi vijon të jetë i publikuar nga APP.

Kërkesa për mostra është vendosur vetëm për ato mobilie dhe elemente për të cilat verifikimi fizik i materialit, përpunimit, stabilitetit, ergonomisë, përfundimit dhe aksesoreve është vlerësuar i nevojshëm për vlerësimin e ofertës teknike. Për artikujt nr. 1 dhe 2 kërkohet mostër e plotë për shkak të përdorimit të drejtpërdrejtë nga fëmijët, ndërsa për artikujt nr. 3, 4, 5 dhe 8 kërkesa është kufizuar në mostra materiali dhe/ose aksesorësh, me qëllim shmanjen e një barre të panevojshme për operatorët ekonomikë. Kriteri është përcaktuar në mënyrë proporcionale dhe mostrat do të vlerësohen vetëm kundrejt kërkesave të publikuara në specif-ikimet teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë për garancinë, nëpërmjet së cilës të marrë përsipër se mobiliat dhe lavatriçja profesionale të ofertuara do të mbulohen me garanci minimale 24 (njëzet e katër) muaj, për defekte prodhimi dhe funksionimi normal, si-pas kërkesave të specifikimeve teknike.

Për **lavatriçen profesionale**, operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se gjatë periudhës së garancisë do të sigurojë shërbimin teknik/riparimin dhe pjesët e këmbimit të nevojshme për defektet që mbulohen nga garancia.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për garanci është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e mallrave, përdorimin e tyre të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe dhe nevojën për garantimin e cilësisë dhe funksionimit normal të tyre pas dorëzimit.

Afati minimal prej 24 muajsh është vlerësuar i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën dhe përdorimin e mallrave. Për lavatriçen profesionale, sigurimi i shërbimit teknik dhe i pjesëve të këmbimit për defektet e mbuluara nga garancia është i nevojshëm për të garantuar vazhdimësinë e përdorimit të pajisjes.

Autoriteti Kontraktor nuk kërkon autorizim nga prodhuesi apo distributori, duke mos e kush-tëzuar pjesëmarrjen me një kanal të caktuar furnizimi ose marrëdhënie tregtare me prodhuesin.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentin “Ofertë Teknike”, sipas modelit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim identifikimin e produkteve të ofer-tuar dhe lidhjen e tyre me dokumentacionin teknik përkatës.

Dokumenti duhet të përmbajë për secilin artikull, sipas rastit:

Nr.	Emërtimi i produktit	Prodhuesi / modeli / kodi, kur aplikohet	Dokumentacioni teknik	Referenca	Shënime
-----	----------------------	--	-----------------------	-----------	---------

Për produktet për të cilat kërkohet dokumentacion teknik sipas pikës 2.3.2, operatori ekonomik duhet të përcaktojë katalogun/skedën teknike dhe referencën përkatëse që mundëson identifikimin e produktit dhe të karakteristikave të tij.

Për mobiliet ose produktet që realizohen sipas porosisë dhe për të cilat nuk ekziston katalog, model apo kod standard prodhuesi, mund të shënohet “Produkt sipas porosisë/specifikimeve teknike të AK – nuk aplikohet”.

Të dhënat e paraqitura në dokumentin “Ofertë Teknike” duhet të jenë në përputhje me katalogët, skedat teknike, vizatimet/skicat, dokumentet e konformitetit dhe dokumentacionin tjetër të paraqitur në ofertë.

Dokumenti duhet të plotësohet në atë masë që të mundësojë identifikimin e qartë të produkteve të ofertuar dhe verifikimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e Dokumenteve të Tenderit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për dokumentin “Ofertë Teknike” është vendosur me qëllim identifikimin e qartë të produkteve të ofertuar dhe krijimin e lidhjes ndërmjet secilit produkt dhe dokumentacionit teknik të kërkuar në kriteret përkatëse.

Duke qenë se objekti përfshin kategori të ndryshme mallrash, paraqitja e informacionit në një dokument përmbledhës mundëson verifikim më të qartë dhe të njëtrajtshëm të ofertës teknike.

Për produktet e realizuara sipas porosisë nuk kërkohet katalog, model apo kod standard kur një dokumentacion i tillë nuk ekziston. Kriteri nuk vendos dokumentacion teknik shtesë përtej atij të kërkuar në pikat përkatëse, por shërben për organizimin dhe referimin e informacionit të ofertës.

Për këtë arsye, kërkesa është e lidhur me objektin e kontratës dhe proporcionale me nevojën për një vlerësim objektiv dhe të verifikueshëm të ofertës.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të **nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar**, si dhe **nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar**.

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisje dhe mobilie për kopshte dhe çerdhe dhe përcaktojnë karakteristikat minimale të nevojshme për përdorimin institucional të mallrave, duke marrë në konsideratë funksionalitetin, qëndrueshmërinë, higjienën, ergonominë dhe, në mënyrë të veçantë, sigurinë e fëmijëve.

Për mobiliet dhe orenditë e destinuara për përdorim nga fëmijët janë përcaktuar kërkesa minimale lidhur me materialet, përmasat, stabilitetin, përpunimin dhe përfundimin e sipërfaqeve, rrumbullakimin e skajeve dhe qosheve dhe shmangien e elementeve që mund të krijojnë rrezik gjatë përdorimit.

Për lavatriçen profesionale, parametrat janë përcaktuar në funksion të përdorimit të vazhdueshëm institucional dhe përfshijnë karakteristika teknike dhe funksionale, kapacitetin, programet, kërkesat e sigurisë, garancinë dhe dokumentacionin e konformitetit të zbatueshëm.

Për kompleksin e lojërave dhe lisharësen, kërkesat janë përcaktuar duke marrë në konsideratë përdorimin e drejtpërdrejtë nga fëmijët, qëndrueshmërinë e strukturës, materialet, përmasat, elementet funksionale, ankorimin dhe sigurinë gjatë përdorimit. Për këto pajisje është referuar standardi EN 1176, sipas pjesëve të aplikueshme, ose standard ekuivalent.

Figurat dhe skicat e bashkëlidhura për pajisjet e lojërave kanë karakter orientues për konfigurimin dhe funksionalitetin e kërkuar dhe nuk përbëjnë referencë ndaj një marke, modeli apo prodhuesi të caktuar. Pranohen zgjidhje ekuivalente që përmbushin kërkesat minimale teknike, funksionale dhe të sigurisë.

Për mallrat për të cilat karakteristikat teknike dhe funksionale mund të verifikohen objektivisht nëpërmjet dokumentacionit të produktit, është parashikuar paraqitja e katalogëve, skedave teknike, vizatimeve/skicave ose dokumentacionit tjetër teknik sipas kriterëve përkatëse. Kjo kërkesë nuk është shtrirë në mënyrë të përgjithshme për mobilitet që mund të realizohen sipas porosisë dhe për të cilat katalogu standard i prodhuesit mund të mos jetë i zbatueshëm.

Për produktet për të cilat janë përcaktuar kërkesa specifike sigurie dhe konformiteti, janë parashikuar dokumentet përkatëse të konformitetit dhe/ose testimit, duke pranuar dokumente dhe prova ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi.

Për verifikimin fizik të karakteristikave që nuk mund të kontrollohen plotësisht vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik, është parashikuar kërkesa për mostra vetëm për artikujt dhe elementet e përcaktuara në pikën 2.3.4, duke kufizuar sasinë dhe llojin e tyre në masën e nevojshme dhe proporcionale.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të përcaktojnë kërkesa minimale teknike, funksionale dhe të sigurisë, pa favorizuar ose eliminuar një prodhues, markë, origjinë, tip apo proces të caktuar prodhimi. Çdo referencë ndaj një standardi teknik kuptohet e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalent”, në përputhje me nenin 36 të LPP-së.

Përcaktimi i këtyre kërkesave është bërë në funksion të nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe synon sigurimin e mallrave funksionale, të qëndrueshme dhe të sigurt, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, konkurrencës dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

Njësia e Prokurimit

1. **Aurora Shkjau** – Kryetare
2. **Nikoleta Logu** – Anëtare
3. **Viktor Sheldija** – Anëtar